

VENDIM
Nr. 660, datë 10.10.2019

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.77, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KONTRIBUTET E DETYRUESHME DHE PËRFITIMET
NGA SISTEMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SIGURIMI I KUJDESIT
SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

1. Pas pikës 12/1, të kreut IV, “Regjistrimi dhe evidentimi i kontributeve”, shtohet pika 12/2, me këtë përmbajtje:

“12/2 Për efekt të përfitimeve sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të njihen si periudha sigurimi të gjitha periudhat nga 1.10.1993 deri më 31.12.2014, për të cilat nga personat e vetëpunësuar në bujqësi janë paguar kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, sipas procedurave të kohës, të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 11.6.2001, nr. 167, datë 29.3.2006, dhe nr. 1114, datë 30.7.2008, “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht vendbanimit të tyre sipas regjistrimit të gjendjes civile në atë periudhë të mbuluar me sigurim shoqëror, me kusht që kontributet të jenë paguar deri në datën 31.3.2015”.

2. Në pikën 8, të kreut VIII, shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur paga mujore mbi të cilën paguhen kontributet dhe kontributet janë llogaritur dhe paguar mbi një shumë më të vogël se paga minimale ose kontributi minimal i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin përkatës, periudha mujore e sigurimit llogaritet duke vënë në raport pagën ose kontributin e paguar me pagën ose kontributin minimal të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, e shumëzuar me 30 (tridhjetë).

Nga ky rregull bëjnë përjashtim muajt me pagesë kontributesh jo të plotë, për shkak se personi ka filluar punë ose është larguar nga puna gjatë muajit. Në këtë rast, për efekt të periudhës së sigurimit merren ditët e punuara.

3. Për vitin 2019, efekti financiar llogaritet në shumën 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, dhe përballohet me fondet e parashikuara në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të këtij viti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 140, datë 17.10.2019